

## I. HYRJE.

Subjekti "BELBA B&B" sh.p.k është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti K88325601F.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në Fshatin Qukës Shkumbini, Librazhd. Objekti i veprimtarisë së subjektit është: "Shfrytëzim nëntokësor i mineralit të kromit".

Administratori i këtij subjekti është Z. Ditver Çela.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me **ID 3.6 Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshëm i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitiv dhe negativ, që influencojnë në treguesit mjedisor.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

## II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit".
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 "për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse".

- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhri e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

### **III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.**

Për të përcaktuar mënyrën e shfrytëzimit janë marrë në konsideratë elementët:

- topografia e zonës së projektit,
- sasia e rezervave të shfrytëzueshme,
- karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve,
- elementët e shtruarjes dhe
- koeficienti i zbulimit

Nga analiza e këtyre faktorëve është parashikuar shfrytëzimi me karrierë dhe galeri i rezervave të llogaritura të objektit. Gjithashtu, shfrytëzimi me karrierë në qiell të hapur favorizohet dhe nga:

- Rënia e formacioneve, që ndërtojnë pakon produktive në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkallëve dhe elemetëve të tyre pa sjellë kushtëzime teknike. (në drejtim të kundërt me terenin me një kënd;
- Eksperienca e shfrytëzimit në vitet të kaluara, ka treguar se elementët e shtruarjes së formacioneve të mineralit të kromit dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë këndet e mëdha të skarpave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rrëshqitje;

- Hidrogarfia e zonës, në përgjithësi dhe territori projektuar për leje minerare në veçanti, nuk pritet të krijojë probleme për shfrytëzimin e vendburimit, mbasi sipërfaqja është plotësisht e drenuar dhe nuk ka probleme ujërash dhe burimesh të pranishme në të.

### **Regjimi i punës**

Për realizimin e prodhimit të parshikuar karriera do të punoje 12 muaj, 20 ditë në muaj me një ndarëse në ditë dhe me 8 orë pune/turne. Në ditët me lagështi, dëborë në përgjithësi nuk do të punohet. Variantet e hapjes së vendburimit dhe argumentimi dhe zgjedhja e mënyrës së hapjes. Vendburimi do të hapet nga rruga ekzistuese që përshkon vendburimin në pjesën jugore dhe perëndimore. Në studimin e varianteve të hapjes së vendburimit, janë marrë në konsideratë:

- Kuota e poshtme e rrugës ekzistuese;
- Kuota e sipërme e zonës së shfrytëzimit;
- Parametrat gjeometrike të zonës së shfrytëzimit si:
- Gjerësia e karrierës në plan në pjesën e sipërme të saj;
- Gjerësia në sheshin e poshtëm të karrierës;
- Gjatësia e karrierës në pjesën e sipërme;
- Gjatësia e karrierës në pjesën e poshtme;
- Shpërndarjen e rezervave të nxjerrshme në shkallë në raport me sasinë e përgjithshme të rezervave.
- Pjerrësinë mesatare më të madhe dhe më të vogël të sipërfaqes së objektit dhe asaj jashtë kufijve të saj.
- Lidhja me rrugë e karrierës.

Mundësinë e lidhjes me rrugë të pjesës së sipërme të karrierës dhe të pjesës së poshtme të karrierës ose duke përdorur zonë e shfrytëzuar në vitet e mëparëshme.

### **Sistemi i shfrytëzimit treguesit tekniko-ekonomikë të tyre**

Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të sterilit.
- Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të mineralit të kromit në brendësi të karrierës dhe jashtë saj.

Si për zbulimin ashtu edhe për nxjerrjen e mineralit do të përdorim lëndë plasëse e kombinuar edhe me çekiç hidraulik. Transporti i mineralit dhe i sterilit do të bëhet me automjet deri në sheshin e depozitimit të mineralit dhe atë të sterilit.

## **Elementet e sistemit të shfrytëzimit që parashikohet të përdoret në këtë objekt janë:**

- Lartësia e shkallës së karrierës
- Gjerësia e sheshit të punës
- Këndi i skarpatës së shkallës
- Këndi i shkarjes së skarpatës së shkallës
- Gjerësia e shesheve përfundimtare të shkallëve
- Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;

## **Mënyrat e rrëzimit të mineralit të kromit në karrierë**

Si për zbulimin ashtu edhe për nxjerrjen e mineralit do të përdorim lëndë plasëse e kombinuar edhe me çekiç hidraulik.

## **Rrëzimi i mineralit të kromit në shkallët e karrierës me lëndë plasëse me bira sonde**

Zona e rrezikshme nga minat është llogoritur për flakërimin e copërave dhe valën sizmike sipas sasisë maksimale të lëndëve plasëse që eksplodon njëkohësisht që nuk i kalon 39 kg. Është marrë me siguri 5 herë duke e rritur rrezën e zonës në 300 metra. Rrëzimi i materialit do të bëhet me lëndë plasëse të vendosura në bira të hapura me çekiç shpues (martel). Shpimi birave si për shfrytëzimin i cili do të jetë me qiell të hapur ashtu edhe për zbulimin do të behën me çekiç shpues të modelit kinez 7655. Do të përdoret një çekiç i tillë sepse pasi kompresori që disponojnë ka një prodhim  $4.5 \text{ m}^3/\text{minut}$  i cili prodhon ajër të mjaftueshëm për të funizuar vetëm 1 martel. Diametri i birave do të jetë (38-42)mm me thellësi nga 1.6 deri në 2.40 ml të cilat do të mbushim me dinamit, amonit në 2/3 e birës. Ngarkesa me lëndë eksplozive për birat me mineral do të jetë më e vogël, për të patur një coptushmëri sa më të mirë, dhe për të ndaluar pluhërizimin nga ana e personelit teknik të kompanisë do të sigurohet kontrolli i vazhdueshëm i punimeve, si dhe hartimi i pasaportave teknike për çdo rast.

## **Plani i menaxhimit të avarive**

Në çdo miniere mund të ndodhin avari. Likujdimin e avarisë e bën Përgjegjësi i Likujdimin avarisë që është njeri i kualifikuar i ngarkuar nga zotëruesi i lejës për të drejtuar teknikisht aktivitetin minerar që në rastin konkret do të jetë inxhinieri i minierës. Operacioni i shpëtimit dhe detyrat për likujdimin e avarisë, përgjegjësi i likujdimin të avarisë e bën me ndihmën e shpëtuesve që në rastin tonë duke qenë së është miniera e vogël dhe ka më pak punëtorë se 25 veta kemi grupe vullnetare shpëtimit të cilët janë të punësuar. Shpëtuesit janë të përgatitur për të kryer operacione shpëtimit, sqarim situatë, likujdim avarie, por kryejnë edhe punë tjetër normale.

## **IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.**

### **4.1. Lëndët e para.**

Shfrytëzimi i mineralit të kromit në këtë objekt është aktiviteti kryesor i subjektit për sigurimin e lëndës së parë, që është minerali i kromit me destinacion pasurimin e tij dhe do të tregtohet për prodhim ferro kromi në tregun e brendshëm ose do eksportohet në tregun e jashtëm. Lëndën djegëse që do të nevojitet për të vënë në lëvizje mjetet e punës, dhe lënda plasëse që do të nevojitet për kryerjen e shpërthimeve për shkëputjen dhe rrëzimin e trupave të mineralit të kromit do të blihet nga subjekte të licensuara për tregëtimin e tyre.

### **4.2. Energjitë që përdoren.**

Objekti është i lidhur me rrjetin inxhinjrik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjrik janë, ai i :

#### **a. Furnizimi me energji elektrike.**

Miniera furnizohet me energji elektrike nga n/stacioni i saj dhe vlerësohet si konsumator relativisht i madh me një konsum mesatar prej 20000 kwh/ditë. Konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike janë kompresorët e ajrit, pompat e ujit, paisjet ngritëse e transportuese, etj.

#### **b. Lëndë djegëse.**

Mjetet teknologjike që punojnë kryesisht në sipërfaqe si fadromat, makinat transportuese të mineralit e sterileve, etj janë konsumatorët më të mëdhenj të naftës, që është lëndë djegëse kryesore që konsumohet në këtë minierë. Miniera konsumon naftë rreth 5000 litra/muaj.

#### **c. Lëndë plasëse.**

Punimet e zbulimit dhe ato të shfrytëzimit, nëntokë poshtë nivelit të XII kryhen me ndihmën e lëndës plasëse. Për kushte normale pune konsumi i lëndës plasëse shkon në rreth 39 kg/ditë.

Lënda plasëse administrohet nën një regjim të rreptë teknik dhe profesional, nga specialistë me përvojën e duhur për të tilla punime.

#### **d. Ajër i ngjeshur.**

Miniera ka 3 kompresorë ajri me kapacitet 40 m<sup>3</sup>/orë dhe, 2 kompresorë ajri me kapacitet 20 m<sup>3</sup>/orë. Këta kompresorë punojnë vetëm gjatë kohës që paisjet e shpimit hapin birat në frontet ku punojnë. Është evidentuar që në 24 orë këta kompresorë janë në punë rreth tre orë.

## **V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të shfrytëzimit nëntokësor të mineralit të kromit, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

### **5.1. Shkarkime në ajër.**

Pothuajse e gjithë veprimtaria e shfrytëzimit të minierës zhvillohet nëntokë, në nivele të ndryshme, sipas fronteve që përgatiten për shfrytëzim dhe të atyre që shfrytëzohen. Kjo do të thotë që shkarkimet në ajër si efekt i shpërthimit të lëndëve plasëse (gaze dhe pluhura), apo i çlirimit të gazeve nga nënshtresat gjeologjike, etj ndodhin nëntokë. Gazet dhe pluhurat shpërndahen në hapësirat punuese apo të shfrytëzuara më para dhe largohen/dalin nga miniera në sipërfaqe nëpërmjet sistemit të ajrimit të minierës. Ky sistem monitorohet në vijimësi dhe treguesit e monitorimit japin të dhëna nën vlerat e standarteve në fuqi për gazet dhe pluhurat.

Punimet në sipërfaqe të minierës, për hapjen e galerive të reja, ngarkim-shkarkimin e sterileve, transportin, etj. shoqërohen gjithashtu me çlirim të gazeve dhe pluhura të cilët ndotin ajrin. Gazet çlirohen nga mjetet lëvizëse që punojnë me lëndë djegëse, ndërsa pluhurat nga lëvizja e mjeteve në rrugët e brendëshme të minierës, nga procesi i ngarkim/shkarkimit, etj. Duhet pranuar që këto çlirime gases e pluhurash janë të përkohshëm dhe të izoluar në vendet ku punohet.

### **5.2. Shkarkime në tokë.**

Aktiviteti mineral ushtrohet përgjithësisht në nëntokë dhe sterilet që krijohen gjatë proceseve të ndryshme sistemohen në hapësirat e shfrytëzuara më parë (brenda në minierë) ose jashtë saj në vende të përcaktuara më parë. Venddepozitimet e sterileve janë të parapërgatitura dhe në pjesë të veçanta të tyre janë ndërtuar mure mbajtës për të parandaluar rrëshqitjen e truallit ose të stokut të sterileve dhe për të parandaluar kështu edhe fenomeneve të erozionit.

Nga përvoja e punës së deritanishme rezulton se nga miniera dalin mesatarisht 0.35 ton sterile për çdo ton mineral kromi të prodhuar. Ndërkohë që sterile dalin edhe nga punimet e hapjes në një sasi prej rreth 100 m<sup>3</sup>/ditë.

### **5.3. Shkarkime të ujrave të ndotur.**

Ushtrimi i aktivitetit mineral në kushte optimale nuk do të ndikojë në treguesit cilësor të ujrave mbi dhe nëntoksore. Këto ujëra mund të ndoten vetëm nga lëndët e ngurta që mund të mbartin gjatë lëvizjes së tyre në rrjedha tashmë të përcaktuara.

Eksperienca disa vjeçare e punës së kësaj miniere tregon se pothuajse nuk kemi raste të prishjes së treguesve cilësor të rrugëve dhe rrjedhave të ujarave nëntokësor. Në zonën e shfrytëzimit dhe përreth saj, nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshe të karakterit hidrogeologjik.

#### 5.4. Shkarkime të zhurmave.

Burim i zhurmave dhe vibracioneve është puna e pasijeve dhe e makinerive të caktuar mbi dhe nëntokë. Burime të zhurmës dhe vibracioneve mbi tokë është puna e eskavatorit dhe e kamionave të transportit, motokompresorëve të ajrit, etj. Ndërsa zhurmat dhe vibracionet nëntokë kanë si burim punën e pistoletave shpuese, lëvizjen e vagonëve të ngarkuar me mineral/sterile, proçest e ngarkim/ shkarkimit të tyre, shpërthimet e lëndëve plasëse, etj

### VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti “BELBA B&B” sh.p.k me NIPT K88325601F, ushtron veprimtarinë e shrytëzimit nëntokësor të mineralit të kroimit në Fshatin Qukës Shkumbin, Librazhd.

Ai është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme sipas sistemis Gauss-Kruger WGS84:

Nr. i pikës	X	Y
1	4557200	4457000
2	4557200	4457300
3	4557700	4457000
4	4557700	4457300

Qyteti i Librazhdit është qendra administrative e Bashkisë Librazhd e cila kufizohet në veri me bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km<sup>2</sup> dhe ka një popullsi prej 31890 banorësh, me një densitet të popullsisë prej 55.68 banorë/km<sup>2</sup>.

Bashkia e re e Librazhdit shtrihet në lindje të Shqipërisë, në një zonë me bimësi të pasur, hapësira të gjera pyjore dhe burime të shumta hidrike. Ajo ka një relief tërësisht kodrinoro-malor. Relievin e bën më të larmishëm fushëgropat si ajo e Studnës dhe e Letmit. Lartësia maksimale mbi nivelin e detit është 2253 m, maja e Kuqe e [malit Shebenik](#). Parku kombëtar Shebenik- Jabllanicë është një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm të bashkisë së Librazhdit.

Krahas këtij parku, në këtë rajon gjenden edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë. Në treguesit e zhvillimit ekonomik të kësaj bashkise peshën kryesore e zë



bujqësia dhe blegtoaria e zonave rurale. Shfrytëzimi i pyjeve ka qenë dhe mbetet një aktivitet tradicional dhe fitimprurës për disa biznese të zonës. Në zonën urbane vihet re një zhvillim i linjave të përpunimit të drurit, gurit e mermerit, qumështit e nënprodukteve të tij, të tregtimit të karburanteve, bar-restorante etj. Mungesa e investimeve thelbësore përgjatë dy dekadave të fundit e ka mbajtur zonën me një infrastrukturë të pazhvilluar veçanërisht në ato rurale.

**Klima.** Pozicioni gjeografik, konfiguracioni i relievit, lartësia absolute mbi nivelin e detit dhe largësia nga deti Adriatik kanë mundësuar një natyrën kontinentale të klimës e cila çfaqet me një dimër të ftohtë e të lagësht dhe me një vërë të shkurtër, të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore është 13,4 °C. Temperatura max. e regjistruar është 40,7 °C (me 14 shtator 1957) ndërsa temperatura minimale është regjistruar -15,7 °C (në vitin 1968).

**Reshjet.** Pjesa më e madhe e reshjeve bie në periudhën e ftohtë të vitit dhe më pak në periudhën e ngrohtë. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit bie 68 % e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë periudhës së ngrohtë 32 %. Shuma vjetore e reshjeve është 1200 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 145 mm.

Reshje në formë bore janë më të shumta në zonën malore të rajonit.

**Flora .** Egzistenca e 1857 lloje bimësh spontane, enezore, të cilat përfaqësojnë 58 % të florës Shqiptare ose 16 % të florës së Evropës, e renditin Librazhdin në një nder rajonet më të pasura të vendit. Këtu gjenden bimë të llojeve të ndryshme, në të gjitha katet bimore. Mbulesa bimore zë rreth 72 % të territorit të këtijë rajoni.

#### **Cilësia e ajrit.**

AKM nuk e ka përfshirë qytetin e Librazhdit në programin e monitorimit të shkarkimeve në ajër, kështu që mungojnë të dhënat zyrtare të nevojshme për pasqyrimin e cilësisë së ajrit. Në qytet dhe në afërsi të tij, nuk ka linja të prodhimeve industriale, të cilat mund të shkaktojnë ndotje të ajrit. Qyteti është nën ndikimin e ndotjeve të shkatuara nga trafiku duke qënë nyje lidhëse e arterive kryesore lindje-perëndim me rrugën Qafthanë – Durrës, si dhe me rrugën që lidh pjesën veri-lindore të vendit, Qarkun e Dibrës dhe të Shtetit të Maqedonisë.

#### **Cilësia e ujrave.**

Baseni i Lumit Shkumbin, është njëri prej baseneve ujëmbajtëse të vendit i cili është monitoruar gjatë vitit 2014. Nga ky basen shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të UN për furnizimin me ujë të pijshëm të Qytetit të Librazhdit dhe zonave të banuara. Shkumbini është monitoruar në katër pika Qukës, Topcias, Papër dhe Rrogozhinë. Librazhd. Cilësia e ujrave në këtë pikë rezulton:

**Përmbajtja e oksigjenit të tretur** është e lartë duke e klasifikuar të cilësisë shumë të mirë, ku vlera e tij varijon nga **9.5 mg/l në stacionin reference Qukës** në 8.2 mg/l në stacionin e ura e Rrogozhinës.

**Përmbajtja e lëndëve organike** rezulton në nivele të ulta dhe klasifikohet i cilësisë së dytë në stacionin referencë Qukës. Kemi rritje konstante të këtij treguesi duke filluar nga stacioni i Topciasit ku kemi shkarkimet urbane të qytetit të Elbasanit të cilët ndikojnë direkt në ritjen e përmbajtjes së lëndëve organike.

**Përmbajtja e NKO** varion në **4.36 mg/l në stacionin referencë Qukës**, në 9.59 mg/l në stacionin Topcias si pasojë e shkarkimeve urbane të qytetit, në 7.2 mg/l në Papër dhe me 7.6 mg/l në stacionin ura e Rrogozhinës.



**Përmbajtja e NH<sub>4</sub>** varion nga **0. 067 mg/l për stacionet Qukës**, -0. 216 mg/l Topçias, 0. 105 mg/l Papër dhe 0.09 mg/l Rrogozhinë. Vlera më e lartë paraqitet në Toplias si rezultat i shkarkimit të kolektoreve të ujerave urbane të qytetit të Elbasanit. Në dy stacionet Papër dhe Rrogozhinë vërehet një reduktim i përmbajtjes së NH<sub>4</sub>. Vlerat e përmbajtjes së amonjakut e klasifikojne lumin e Shkumbinit të cilësisë së dytë.

## **VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.**

### **7.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme, në mjedis.**

#### **a. Shkarkime në ajër.**

Në ajër do të shkarkohen gaze dhe pluhura që dalin nga nëntoka (zhvillimi i punimeve për kërkim-zbulim dhe shfrytëzim) si dhe, gaze e pluhura që shkarkohen nga makineritë e pasijet që punojnë në sipërfaqe.

Duke vlerësuar treguesit teknik dhe parametrat teknologjikë të punës të paisjeve të sistemit të ajrimit të minierës si dhe treguesit e monitorimit të ajrit të shkarkuar nga miniera, ne presim që shkarkimet e gazeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të kromit edhe në vazhdimësi do të jenë brenda standarteve në fuqi.

Shkarkimet e gazeve nga mjetet e transportit janë praktikisht të pa monitorueshme, dhe me efekte të përkohshme për shkak të punës periodike të tyre.

Gjithsesi, për të shmangur shkarkimin e gazeve tej normave të lejuara nga këto mjete, si dhe gjithë veprimtaria e këtij subjekti ne do të rekomandonim:

- ❖ Përdorimin e lëndëve djegëse, me tregues cilësor brenda standarteve në fuqi, veçanërisht në përmbajtjen e sqfurit, plmbit, etj ; Konformë Aneksit Nr 7 “*Kërkesat mbi cilësinë e lëndëve të djegëshme për djegie në të gjitha buimet e ndotjes dhe për përdorim nga konsumatori i gjërë*” i VKM Nr 435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”. { normat e përmbajtjes së sqfurit ( % peshë) lëndë të djegëshme të lëngëta 1,0% vajra për djegie 0.05%. Përmbajtja specifike e kufizuar e sqfurit në lëndët e djegëshme përbën përmbajtjen më të lartë të lejueshme të komponimeve të sqfurit të shprehur si sqfur në gram, në lëndën e djegëshme në gjëndje origjinale lidhur me kapacitetin termik të saj. Përmbajtja e kufizuar e sqfurit në lëndët e djegëshme të lëngëta përbën përmbajtjen më të lartë të lejueshme të komponimeve të sqfurit të shprehura si sqfur në përqindje në peshë }
- ❖ Kryerjen e shërbimeve teknike për mirëmbajtjen e të gjitha pasijeve dhe impjanteve, përfshi këtu edhe mjetet e teknologjike dhe mjetet e transportit.

Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të minierës, lagia me ujë e tyre sidomos në stinën e thatë, mbulimi i mjeteve të transportit, do të jenë masa efektive për zvogëlimin apo eliminimin e grimca të ngurta (pluhurave) në këtë minierë.

## **b. Gjenerimi i zhurmave.**

Duke patur në konsideratë burimet e gjenerimit të zhurmave dhe vibracioneve, vlerësojmë se ato janë të karakterit të përkohshëm. Analiza e frekuencës dhe intesitetit të zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato janë nën mesataren e frekuencës 200-2000 Hz, frekuencë e pranushme nga veshi i njeriut. Gjithsesi ne do të rekomandonim përdorimin e mjeteve mbrojtëse individuale nga punonjësit që shfrytëzojnë këto makineri e pajisje.

## **c. Ndriçimi**

Puna nëntokë si dhe ajo mbi tokë në turnet e dyta dhe të treta, detyrimisht kërkon ndriçim artificial jo vetëm të ambjenteve të punës por edhe të rrugëve ku lëvizin punonjësit, ambjeteve hidro-sanitare, zyrave, etj. Tashmë janë të njohura standartet në fuqi që duhen zbatuar si për sigurimin e :

- ✚ sasisë së mjaftueshme të ndriçimit ;

- ✚ drejtimit më të favorshëm të tij, për ndriçim të plotë dhe pa dëmtuar njeriun

Ne do të rekomandonim jo vetëm zbatimin e kërkesave të mësipërme por, edhe ndërhyrjet e nevojshme për zëvendësimin e plotë të ndriçimit inkandeshent me atë luminishent.

## **d. Nxehtësia**

Zvogëlimi apo eliminimi i efekteve negative të nxehtësisë në nivelet e punës nën tokë, mendojmë se mund të arrihen në se operohet me kujdes të vazhdueshëm me parametrat teknikë të sistemit të ajrimit të minierës. Në se vëmendja kryesore përqëndrohet në sasinë e nevojshme të ajrit të pastër që duhet dërguar në çdo fron prodhimi dhe në tërësi në të gjithë minierën, mendojmë se duhet treguar po kaq kujdes edhe në tregues cilësor të ajrit si :

- ✚ Lagështia ;

- ✚ Temperatura;

Në këtë mënyrë mendojmë se do të përmirësohet dhe rregullohen parametrat e mikroklimës në frontet e punës.

## **e. Shkarkimet në tokë**

Sipërfaqja e përgjithshme që zë ky objekt nuk është i kultivueshëm dhe nuk kategorizohet në livadhe e kullotë.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit minierar krahas mineralit nxirren në sipërfaqe edhe sterilet. Venddepozitimet e sterileve janë të parapërgatitur dhe, në pjesë të veçanta të tyre janë ndërtuar mure mbajtës për të parandaluar rrëshqitjen e truallit ose të stokut të sterileve dhe për të parandaluar kështu edhe fenomeneve të erozionit.

Material steril depozitohet në vendet e shfrytëzimit është i pastër dhe me tregues fizik, petrografik dhe kimikë gati të njëjtë me ato të depozitimeve deluvionale të mbulesës si dhe të shkëmbenjve masivë rrënjësor. Gjatë shfrytëzimit të objektit nuk parashikohen depozitimi llumrash.

Aktiviteti minierar në këtë objekt pothuajse nuk prek sipërfaqen e tokës dhe nuk e tjetëron atë.

Për shmangien dhe parandalimin e erozionit, shëmbjes së sipërfaqes dhe vithisjeve të ndryshme, në projektet e zhvillimit të minierës është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i

kombinuar në kohë dhe hapësirë i zonës në tërësi. Sipas këtyre projekteve, në vijimsi të aktivitetit, në zonën e shfrytëzimit do të vazhdojë mbushja dhe sistemimi i truallit, përpunimi dhe mbulimi i sipërfaqeve të vogla të cilat mund të dëmtohet nga depozitimi i sterileve dhe mineralit. Këto sipërfaqe të trajtuara do të krijojnë mundësi për mbjelljen në to, të bimeve dhe pemeve të llojeve të ndryshme të zonës. Kështu jo vetëm krijohen kushte për parandalimin e erozionit por, përmirësohet mjaft pamja e përgjithëshme e zonës së shfrytëzuar.

Subjekti ka programuar edhe trajtimin e sterileve të depozituara në vite, në impjante të posaçme me qëllim marrjen prej tyre të oksideve të kromit që shkojnë deri në 6 %. Në këtë mënyrë fitohen të ardhura nga "rritja" e prodhimit të mineralit të kromit. Vlerësuar nga pikpamja ambientale, realizimi i këtij projekti do të sjellë në zvogëlimin e sasisë së sterileve të depozituara, duke ulur sipërfaqen e truallit të zënë prej tyre dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Trajtimi i sterile mund të bëhet duke i shitur ato edhe tek subjekte të tjera që tashmë kanë aktivitet të kësaj natyre dhe më tej në subjekte që merren me ndërtimin e rrugëve, etj.

#### **f. Mbetjet urbane**

Në minierë punojnë rreth 25 punonjës të cilët krijojnë edhe mbetje urbane të cilat do t'i shtohen mbetjeve urbane nga veprimtaria e minierës. Në përbërje të këtyre mbetjeve do të jenë lëndë të tilla si plastika, qelqi, letra/kartona, etj. Në investimet e kompanisë duhet të përfshihet edhe vendosja e koshave/kazanëve për mbledhjen e përkohëshme të tyre si dhe përcaktimi i një venddepozitimi të përkohshëm deri në largim nga kompani të specializuar në bashkëpunim me pushtetin vendor. Sasia e mbetjeve urbane të pritëshme është rreth 15 kg/ditë ( 25 punonjës x 0,6 kg/person/ditë = 15 kg/ditë) Këto mbetje janë si mbetjet urbane të krijuara në qytet.

Mirëadministrimi, sipas normave përkatëse në fuqi, i mbetjeve urbane, shmang ndotjen e mundëshme të tokës, ujrave sipërfaqësore dhe ajrit.

Masat zbutëse për fazën e operimit dhe programi i monitorimit janë dhënë në mënyrë të përmbledhur në tabelat në vijim.

**g. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.**

Nuk vlerësohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

**h. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme" për t'u shpallur "Peisazh i mbrojtur".

**i. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të shfrytëzimit nëntokësor të mineralit të kromit nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

**7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.**

**a. Vlerësimi i ndikimeve.**

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjrike egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësime të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohëzgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

#### **b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

#### **c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

#### **d. Kthyeshmëria**

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe rigjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

#### **e. Rëndësia.**

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloji ndikimit të identifikuar.

#### **f. Llojet e ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte).**

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të shfrytëzimit nëntokësor të mineralit të kromit, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

### **VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.**

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjejmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe

funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përqendrim të treguesve cilësor aktual të mjedisit.

## **IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.**

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjerie të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluar si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

## **X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).**

Drejtimesit teknik dhelgjor të subjektit i kanë kushtuar vëmendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar krahas mineralit nxirren në sipërfaqe edhe sterilet. Venddepozitimet e sterileve janë të parapërgatitur dhe, në pjesë të veçanta të tyre janë ndërtuar mure mbajtës për të parandaluar rrëshqitjen e truallit ose të stokut të sterileve dhe për të parandaluar kështu edhe fenomeneve të erozionit.

Material steril depozitohet në vendet e shfrytëzimit është i pastër dhe me tregues fizik, petrografik dhe kimikë gati të njëjtë me ato të depozitimeve deluvionale të mbulesës si dhe të shkëmbenjve masivë rrënjësor.

Në minierë punojnë rreth 25 punonjës të cilët krijojnë edhe mbetje urbane të cilat do t'i shtohen mbetjeve urbane nga veprimtaria e minierës. Në përbërje të këtyre mbetjeve do të

jenë lëndë të tilla si plastika, qelqi, letra/kartona, etj. Në investimet e kompanisë duhet të përfshihet edhe vendosja e koshave/kazanëve për mbledhjen e përkohëshme të tyre si dhe përcaktimi i një venddepozitmi të përkohshëm deri në largim nga kompani të specializuar në bashkëpunim me pushtetin vendor. Sasia e mbetjeve urbane të pritëshme është rreth 15 kg/ditë ( 25 punonjës x 0,6 kg/person/ditë = 15 kg/ditë) Këto mbetje janë si mbetjet urbane të krijuara në qytet.

Mirëadministrimi, sipas normave përkatëse në fuqi, i mbetjeve urbane, shmang ndotjen e mundëshme të tokës, ujrave sipërfaqësore dhe ajrit.

## **XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.**

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit European. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjie të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

## **XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjrike (ndërtesë, rrjete inxhinjrike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarie.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do të hidhen mbeturinat që do të krijohen, metalike, plaste, inertesh etj. Çdo të bëhet me truellin pas lirimit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarie nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluara. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

### **XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.



Parametri	Frekuenca e monitorimit	Metoda/teknika e analizës
Ndotës të ngurtë	Çdo 6 muaj	Sipas standartit
Ndotës i gaztë	Çdo 6 muaj	Sipas standartit
Zhurmat	Çdo 6 muaj	Sipas standartit

- FUND-

*Emel Benja*



**LOERMA SHPK**

Laborator i Akredituar  
Gjithmone pranë jush!